



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 3433 prot.

Shkodër, më 07 . 11 .2022

V E N D I M

Nr. 222 , datë 07 . 11 .2022

**“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË NIVELIT TË PAGAVE TË  
PERSONELIT AKADEMIK NË USH”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 38, germa h; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar; VKM nr. 748, datë 11.6.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 7; Udhëzimit të Përbashkët të MAS dhe MFE nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2022, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administratori i USH-së,

**Vendosi:**

1. Miratimin paraprak të pagave të personelit akademik të USH-së, në kufirin maksimal të tyre sipas Lidhjes nr.1 “Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” të VKM-së nr. 748, datë 11.6.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 7.
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal të përballohet nga të ardhurat që realizon USH.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, por i shtrin efektet financiare prej datës 1 tetor 2022.

**KRYETARI**  
**Prof. dr. Sazona GOLEMI**



The stamp is circular with a blue border. Inside the border, the text "UNIVERSITETI I SHKODËR 'BURRËRISË'" is written in a circular path. In the center of the stamp is the coat of arms of the University of Shkodër, which features a shield with a double-headed eagle and a sun. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.